



UNIVERSITÀ DELLA CALABRIA
DIPARTIMENTO DI LINGUE E SCIENZE DELL'EDUCAZIONE
LABORATORIO DI ALBANOLOGIA
UNIVERSITETI I KALABRISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVET DHE I SHKENÇAVET TË EDUKIMIT
LABORATORI I ALBANOLOGJISË



Opere di Francesco Antonio Santori

a cura di

Vincenzo Belmonte

FRANCESCO ANTONIO SANTORI

MELLODRAM' I VIII
MILLOSHINI E PJETROSHINI

Vetëtë

Milloshini, Pjetroshini	<i>vëllezërë</i>
Emira	<i>jëma</i>
Rozbardha, Monostan'ja	<i>motëra</i>
Qirjaku	<i>shërbtorë ghuallanë</i>
Panaidhja	<i>shërbëtresh ghuallane</i>
Körë ghanjunëshi e vashashi	

Shena ësht

ndë një shpî pushtjere ndë male të Dhibrës e larëte.

Hapet shena ndë një sallë të madhe, ku shihen vashaz

e ghanjunë çë shtronjin triesën bashk me Panaidhen

e Qirjakun të tire prind.

<i>Pan</i>	Shtroje mirë atë mbësallë, vashza ime, e vërë më rë ndë shërbise çë ti bënë, se na sot një nderë të madhe, sa ng' e patim nj' etërë herë, riçivirëmi ndë shpī tënë. Zonja Emirë e Monostan'ja, Pjetroshini e Milloshini me Rozbardhën të fanmire vash e bukurë, tas me nē kemi sod, o çë harë!	5
<i>Qir</i>	I mbjodhe lulet çë të thash, o birë? E, ti jetëri, sa tufa trondofile pjekse bashk me lile e me jaçinde? Harrove gjëllsominin, ç' ë te llaka, e amarandin , ç' ë te kroi proposh? Rigan'jelin e mbashke me riganë e gjerin tullipanë, e mirudhiren mellis e kë kultuorë me ato gharofal ndrishe kojllori çë te fonda janë?	10
	Kjo dit ju vete, e si kjo ndonj'etërë kush mund e thëtë ndo se ju ndodhet më? Sod neve japën nderë, e lusëme ka të tjerë, neve të zotërat [t]ënë, e sot na nget	15
	t' i zbulonjëmi namurë e mallë të madh te kï pushtjerë lughadh e te kjo shpī, çë, sa kultonjë u i zï, e i kamë ca vjet, kurraj pati një hjë trilarëte kaq	20
	të vinej të mënoj këtu fëmila të zotravet një jav, moj mëngu dit.	25
	Andaj, nani çë kemi kët pëlqeme, trashigonjëmi hareme këto krede. Stolisni më se mundni stanë mirë, e kriet mbuloni me kurora ndrishe,	30
	e unaza bukurushe e anaka shumë vëni ndë llörë e qaf, e vëthtë bëni luleshi edhe të jenë, e, kurë ata të henë,	35
	prë nënë ju i lodroni mbë valle, e një kangjele pra i këndoni.	40
<i>Pan</i>	Qirjak, Qirjak, bëj nje, se u mbjodhtin gjith e hitin tas ndë shpī. E shtrove e je pastrove triesën mbaru me buk e verë e me talurë e qelqe,	45
	grep e shibuza e tjera kafçe holla?	
<i>Em e të thënëtë</i>	Qirjak e Panaidhe, anangasë mos mirrëni aq prë në; na duomi sod	

	të rrimi ndë pushtjerë jo si ndë pllese, anamesa shërbise e bëgatrë të bulërishta; na pëlqenë këtu të trashigonjëmi ajrin më lefterë, më thjellm' e më dulirë; e një lligjal mbi badhëra je vënë e pa talurë prë ndënë; një bardhullore	50
	e njomthe gjiz mbi fierin e mbërparturë; te kupza qumshti ëmbël e buka e njomë, e ngrohte po si ësht ka furri e dal, na japën një levromë çë nëng e pamë një herë te gjella. Ndo ni kini mallë të jipni neve luturë një pëlqeme,	55
	të jetë hareme e jo mbëshuome juve, bëni si na ju thamë, e prë pather ndë zëmër' u më ju kamë.	60
<i>Qir</i>	Sëmadhi Pjetroshinë, jushtrorë fanmirë, e ti, ghavnarë e doqi Milloshinë, çë sot më mbitëni me një shkëlqeme nderë, sa ng' e penxova o ëndrra ndonjë herë, uli si mundni më te triesa ime	65
	e shtruorë me vobkëtë, moj e bëgaturë me tëjen lart presenxje e hjenë të madhe, çë ndënjin këto zonja trishkëlqeme, fanëbardha e të dulira, të bukura e të mira, cila njohën	70
	ndë vende gjith, çë shohën ndë kto anë një zëmërë çë ju do e vete nënë si pallarë tue bënë sa juve nget.	75
<i>Mill</i>	Buftomja zëmërishte çë na bëre vëlenë më se një tries çë mund na shtroj	80
	Lisëndri o Pirri o rregji i Napulës o Turqvet zot' i madh. Me sa harë ni hamit ndë ktë aradh së kemi ngrënë një herë kurraj gjakunë si me këta ghanjünë.	85
	E shoqja jote e i bukurë kë pushtjerë, këto fusha të gjera e ato male çë neve rrinë kundrela, mua ndë shpirtin përhapnjin një pathënëme hajdhë e gjith kjo shokërë gjegjën ashtu,	90
	kamë bes, edhe si u.	
<i>Mon</i>	O Milloshinë, trë llustre janë çë zbora mbi jetë, e te kjo dit jamë e gjëzonjë vetëm, ndo mbrëmën arvonjëmi po si e zumë hareme e rrishkëlqeme. U çë kurë leva	95
	e mbllirë nd' atë pëllas ku rriturë qeva,	

	<p>lume së kishnja parë, jo luca o zale, monu të larta male të mbuluora me faje fjetullore e trasha pine, çë qiellit bënjin hjë me gjera dega, e llaka shumë të thella e trëmbllore e dushqe merëngore e hapta rehje me terimone gjelbëra, çë kanë një bukurî trilarte mbë vetëhenë, cila më të pëlqenë sa më i vë rë e ndë gjith anë e ruonë me fizikî.</p>	100
	<p>Më kishin thënë ndë plas se ashtuposht i vogëlibh një zog i thënurë rrosinjollë me zanjezen të hollë e pjono hirë shprishij ndë llaka, terimone e brinja një t' emblez armoni, cilën së mund e bëj qitera jonë, ndo mëma e ngit o me të shpejten dorë Rozbardha, motëra ime, bën' e flitij, si kâ zakonë të bënje, ndo rrî me oreks.</p>	105
	<p>Gjëllinja u ndë zëe një mallë të madh të gjegjenja o të shihnjë këtë zog. Kurë somenat proposh prej lumi, nënë një qënd, ndodha se di këndojojn afërë e nj'etërë më tutje, e marmaroste atje kishnja qëndruorë.</p>	110
	<p>Të parën herë më mundi një cjudhî e madhe shumë, pra mua hiri ndë zëe emblishte ajo armoni e një penxerë nje më dhifizi trutë, një mallë çë s' dî të thomë se ç' ish më mundi gjith e u së gjegja më ku ishnja, e ni këtu së gjëndça tas me jū, mos shkoj atena tue mbjedhurë lule një llojë ghanjunë,</p>	115
	<p>cilit më zgjuonë ka trïpëlqemi gjumë. <i>Em</i> O bila ime, më kultonë ti poka e më bekonë më herë, se u të solla të trashigonje ndë kto rea pëlqeme ca hire, çë së kemi ndë shpít [t]ona,</p>	120
	<p>kurë, bashk me motrëmat [t]ënde mbë kuvend të mbjedhura, i rrëfienë këto shërbise çë pë ndë këto vise e ato s' i panë?</p>	125
<i>Mon</i>	<p>E kush mund i harronj? Më hitin thellë ndë zëmërë e, sa ndë gjellë më lë Perndia, së dalën më ka shpirti ku qenë shkruora. U taksinjë çë nani ka pjesa ime, prë sa të jemë e zonja, e ka jetr' anë lusinjë e parkalesinjë kuj më ngat</p>	130
		135
		140

	se allmonu di o trī herë ka mot e vit dua qellurë di o trī dit tē rrī pushtjerë.	145
Roz	E u së vinjë me tij, o Monostane?	
Mon	Nisemi gjith, e vetëme lëmi shpīnë ndë duorë tē shërbëtorëvet, se prana e çonjëmi pjot si vē, kurë priremi ndë hjë tē vrërtullore tē sallavet tē xheshura gjithsej.	150
Em	She' se vidhjuze jē? E vetëme ti do tē gëzoç, moj Zoti tē shterghonë. Ni ti u harepse se, ndë plas kurë jemi, vinjin gjitonet motrëma e ti vet anamesa ndë rrole vëhe e fjet, e mosnjeri tē pipën pas një fjal. Moj u tē thomë nani përpara këtu mëm's e tē së di vëllezërvet [t]ënë se somenat ti vetëm një pëlqeme pate e jo më; e u di tjera skisa çë nëng i prothe ti. Kënduomen gjegja tē rrosinjollit e tē nj'etërë zogu	155
	çë kish nj' unaz prej cimbëthin tē kuqe, barkun e kish tē bardh e ndë krah mbal zezeshkëlqeme malezat buftoj tē pendavet pindiksura një verdhi si ai çë kanë tē spartulloret lule,	160
	gjith i gjallë e shkëlqemë, i thënurë kardhulliqe, e bukurisht këndo prë ndë mbi dega tē nj' ulliri. Moj nj' etërë trashiguome keq tē madhe u pata çë ti s' pate e ani t' e thomë, e ndo se tē pëlqenë u s' e godinjë.	165
	Pë lucën atje proposh ndë llak tē gjerë ka vjenë i bardhi Drinë e lucën vete hinë, e prana dalurë përzihetë me tē jetrin krah, çë posht zdripet ka mali çë ja thon' i zī.	170
	O, se atë luc vërteta kush ng' e pā, ndo se rrëvonë tē des me atë ngulli, Parrajsin nëng e skisen dreq tē tërë! Çë mund rrëfienjë ka bukuria çë kā? Ësht uji kalthërë keq një shesh i madh,	175
	ku zbiret siu tē ruonjë tutje mbatanë zallin tē jetërë e ng' e rrëvonë kurraj. Qiellin tē thellë pindiksurë sheh te fundi mbjatu si nj'etërë qiellë, me rē o pa rē,	180
	e me diell e me hënë çë rrëmbësonjin, ashtu sa s' mund i ruoç, e shkapërdhiksnjin peshqit prë nd' uje ndrishe, e venë e vinjin	185
		190

	dejtrorë me aniza vogëlaz o të madhe; me angurë e me rrjete shumë të gjera pishqit, çë s' kanë mallixjen t' iknjin thellë ndë fundin ku ng' arvonë jo angurë e jo rrjet, të ndërlisksurë i zënë. Ishin prej zalli nënë meje ca voparele tue kullo surë.	195
	Mora ahienë njinje një grusht me vola e shura e ja shtura mbi uj me vrundullim;	200
	e ujtë bëri shkomë e pikaz pikaz u ngre prej qielli e râ mbi lucën nj'etërë herë, e pishqit më ng' u panë, njera ç' atje proroi një vark me rrjete, me kanoja e cado tjera strumende gjith të mbledhura mbi pup. U mbeta e asi vendi nëng u tunda.	205
	Kurë u kallartin, pë se pishqit kînë të gjallë ndë një tin'jel. Deshë të zënja një e ai zû mua. U ika ahienë e dhëmburë e shoket gjith i lë,	210
	çë prana më rrëvuonë ndë një barere. E ulurë ndë një hjë u vet këndonja pa diturë se çë thojnja. U vrëjte ti nani, se pë më u se ti!	215
<i>Mon</i>	Çë pë, çë pë, spakune? Nani rrëfienë se vajte ti ndë qiellë o perivolin pë të magjepsuorë të Fatavet, ku pather paravera lulen mbi lule shtonë, e pemullore pa vap përhapet vera, e ëmble vjeshta	220
	të rrushullore vreshta e tjera mira gjëllinë pather dulira, e teku moti ajrin me breshërë e shî ng' e thturbullonë e bora nëng buftonë faqen kurraj,	225
	ndomos mbi male llargha prë pulqeme të njerzëvet. Sa ngrëhemë së ngrëni, më qellën Pjetroshini ku ti qeve e vëhemë mbi varka e vemi mbal	230
	ndë lucën tue voziturë si dejtrorë, e marrëmi më pëlqeme na se ti...	235
<i>Em</i>	Serposëni këto lufte me u përqeshurë, sa gjegjëmi një kangjelez émbëlore, çë më ndoti se gjegja pak përpara	

	ajashtaz o ndë shpī prë mbrënda atej.	240
<i>Mill</i>	Qirjak, kush ësht atej çë vjershe shtie kangjele këndonë armonisore ashtu sa më rrëmbejin mendën gjith?	
<i>Qir</i>	O zot i madh, janë shërbëtorit [t]ënd, janë timit bil, çë prë harenë çë kanë, se ini ju këtu, u kurōruonë me lule e një trëkuz larushku bëtin e ndë një deg të lartullore e ngjin të lisit i trimadh ndë shesh i rriturë përpara kësaj shpī je pushtjerote, ku bredhën ndë gjith krëmëtet, e tuke u ninuluorë haremë këndonjin.	245
<i>Pjetr</i>	Thirri këtu njëmend, se duom t' i shohmi!	
<i>Mill</i>	Të vinjin tue kënduorë, se duom t' i gjegjëmi!	
<i>Roz</i>	Kurorat le t' i mbanjin po si gjënden!	255
<i>Pan</i>	Njota se vinjin pa të jenë thërriturë.	
<i>Qir</i>	I lë të hinjin para juve, o zotëra?	
<i>Em</i>	Leji të vinjin nje, mos të mënonjin!	
<i>Pan</i>	Ngani këtu nani si gjëndi, o djelma, e pas atire hini edhe ju, vashaz.	260
<i>Mon</i>	Popo, si u stolisëtin me ato lule e të bukurë ashtu duken si ëngjël.	
<i>Em</i>	Këndoni, via, një t' ëmbëlore kënëkë si do të vinjë ndë gol juve ka zëmëra e pëlqemez, dulirë e safëtesëme, të këtë mendirën, po si kini shpirtin.	265
<i>Pan</i>	Të zonjësë gjegjëni urdhrin e këndoni, e si mbi valle ni di kore bëni.	

Kōr'i parë

	Ghanjunëtë Kush e shtroi, kush e pastroi, kush nderoi triesën?	270
	Të pëlqeme, të hareme, thon'je, vashaz, kush e bënë?	

Kōr i dit

<i>Vashazit</i>	Ndë gjith mote, ndë gjith hera bëri triesën buka e vera. Vërë mbi të sa më ti do, se, ndo triesa ësht pa to, gjet vëdekurë i stolisurë, gjet një zog i gjallë spendisurë.	275
<i>Pan</i>	Popo, popo, çë bumbllimë bumbëlloi neve prë nënë?	280

<i>Mon</i>	Më taraksi zëmërën!	
<i>Roz</i>	Si u verdhe ndë njëmend, si kurë t' ish përpara tij ndonjë draghorë me sī të kuqe e me gol të hapte, cila të dërgoj vava prë jashta farmëkore e vëdekkore!	285
<i>Mill</i>	Gjegje dreq, o mëmë, çë qe?	
<i>Em</i>	Mua m' u ndot një strush i madh, si një lis çë, prerë, prë trolli bie me madhe vrundullimë.	290
<i>Mon</i>	Një gjëmimë më shumë e rënde mua m' u duk e bumbllisore.	
<i>Pjetr</i>	Le të jëtë çë do! Këndoni ju, ghanjunë, me më duli se këndo jit pak përpara.	295

Kor'i parë

Si një zonjë e nikoqire
shpînë bëgatën e je nderonë,
buka bënë të fanëmire
ato triesa ku mburonë. 300
Buka kurmin gjall' e mbanë,
buka shpirtin e përlanë.

Kör i dit

Si një kuvend me trima,
çë tuke bredhurë qeshnjin
e lodra e lufta bënjin,
mos nëng i tundën frima
grarishte e kopilishte,
fëtohetë gjith e mbë serpos lëngonë;

ashtu triesa pa verë
na gjet një paraverë
pa lule e po si vreshta
pa rrush o pema vjeshta.
Vetëme vera ëndën hapën e gjinë
e siellë harenë ndë vendë kudo hinë.

Körë i parë

Me kojllorë, me sapurë,
me hajdhī çë vera jep,
neve thanë se Anakreondi
tue kënduorë e tuke shkruorë
rriti nj' èmërë çë së des.

Kor'i dit

	Buka e vera ndë gjith hera qe fuqia të kësaj jetë ...	320
<i>Em</i>	Ajlimono, çë bumbullimë di herë bumblloji si draghonarje madhe gjëmë!	
<i>Mon</i>	Me ajrin të thjellmorë çë shohmi nënë si gjënjin vend gjëmimë e bumbullima?	325
	Ka dalën, kaha vinjin e ku venë, pa rë, pa borë, pa shi? Mua zëmëra parathot nj'etërë s'hajdhi...	
<i>Mil</i>	I Dil, Pjetroshinë, vëlla, dil jasht e vrej ka mbal nië rahj o terimonë kësoj çë janë këto bumbllima. Ndo mali janë gjëmima, ea ndër në të trashigonjëmi ditën me harë çë ndë menat prë njera ndë strapos. Ndo prana të jënë Turq e të jënë pak, ti lufëtoji vet; ndo shumë të jenë, ti prirë nje këtu, se vinjë me tij dhe u, e shohëmi të buftonjëmi sa vëlenë me gjakun krahu çë ka Pirri vjenë.	330
<i>Pjetr</i>	Më nje se ti ng' e thë, u jamë i gaturë. Njota se nani vete e bënë sa kumandove zotria jote.	340

Niset vrap

<i>Em</i>	Shkëlqeme u dī menata sod prë mua, moj mbrëma ndë strapos ng' arvonë thjellmore e trëmbemi se shkrete më lë si murge grua.	345
<i>Roz</i>	U gjegjinjë çë nani një zae merore, çë më thirrën ndë vesh dju cilin dëmë e ndë zëmërë më vete si magjepsore nëmë.	350
<i>Mon</i>	U varesa njinje të rrī këtu.	
<i>Em</i>	Ndë kët njëmend prodhoj më neve shpia e na pëlqeju dulja e horëtishte më shumë se gjith haretë çë kā pushtjeri ...	355
<i>Mill</i>	Çë janë këto aughure ligullore çë bëni vetëuj e agëzoni dëme më parë se moti, e çë pri s' llarghu të keqat i thërrini? Ju tjera grā, së dini ndomos të shihni liga ndë gjith vende,	360

	të bëni ashtu skutjende, kudo gjëndi, të mbjedhurat kuvende mbë harë.	
	Ka shihni ju se dalën këto rë të zezullore, çë trëmbimje rëndi?	365
<i>Qir</i>	O birë, ndo përmëtonë se të nderonjë u timen gjuh me këto ëmbla fjal, e të thomë një vërtet njojurë ka gjith, moj nëng e masurë ka një vet njeri, si plak të fjas, çë gjellën tas e shkoi e pësuome dhuroi pa nëmërimë.	370
	Zëmra bërishte e malli edhe nëng ësht si prindërishtja zëe e malli i tire. Llumbardha dridhet mbi të sajat bil, edhe kurë era fjetat shtrushullon të fitepsit, ku bëri ajo folenë,	375
	se t' qiftit duk se ndjenë vrundullimën çë bënë, kurë harta krah mbi ajrin fjuturonë.	
<i>Mill</i>	Kjo ligjërate, çë më bëre, o plak, trënderëmi Qirjak, vërtetën thomë se ësht norë e më pelqenë më shumë se ti nëng e kë bes. Mbero u dë se një shpirt çë s'hajdhitë i sheh më parë po të rrëvonjin, madhën dëmin keq e trimat i bënë pjeq më parë se moti, gjellën tuke shtrënguorë me më dhurime, veç pra se cado herë të ligat, çë së janë, i ngjallën e bën' e kanë një rëndullore të qënurë, çë s' e kishjin pa trëmbime.	380
<i>Em</i>	U pruorë, u pruorë! Çë qe, o Pjetroshinë?	
<i>Mon</i>	Prostekse gjë të lig o gjë të mirë?	
<i>Roz</i>	Qenë shiu o ishin ndrishe ato gjëmime?	
<i>Pjetr</i>	Nje armatosu e dil me mua, vëlla!	395
<i>Pan</i>	O qinë e madhe! E çë të jëtë prë në?	
<i>Mill</i>	Çë ndodhe poka o pë?	
<i>Pjetr</i>	Vinjin prej neve Turqish di llojë.	
<i>Roz Mon Pan</i>	O zjarmë çë na rrëvoi!	
<i>Mill</i>	Ku janë nisurë të venë, çë duanë, çë kanë, si t' armatosurë janë?	400
<i>Pjetr</i>	U besinjë, vëlla, se janë një pjes të nj' etër' ushtri, cila me Mojsenë ndë këtë herë jushtronë mbi Dibren, se bumbllonë atena mali.	401a
	Vemi mbi ta, pa zbjerrurë një njëmend, se gjënden tek një vend, ku na të di mund i luftonjëmi gjith edhe pa kuel.	405
<i>Mill</i>	Vemi njëmend.	408a

<i>Em</i>	Çë thua, trimoth pa trū?	408b
	Sa shpata kini tē luftoni ju me gjind mbë qindinarë?	410
<i>Pjetr</i>	O mëmë, kemi një parë çë sosnjin neve tē vrasëmi Turq sa më tē jenë te llaka. Vemi, se ndë birraka, tek u mbllinë, së dalën si tē duanë mbë dhë tē mirë. Ti vëhe atena e u këtej me dirë	415
	e i japëmi grop ku vanë t' e gjëjin vetë.	
<i>Em</i>	Popo, si zëen më nget kjo rënde fjal!	
<i>Mill.</i>	Mënoni ju këtu pa një trëmbime, mbë hareme gëzime, po si mbetim njera njëmend.	420a
<i>Mon</i>	E kuj ja thua këto? Një jëm' e vetëm e lënë me di kopile tē bila jasht ka shpia, nd' atë njëmend çë tē biltë lufëtonjin mbë di vet kundurë milarë, jo zet, rrī e pushonë e hareme gëzonë? Spartanet grā	420b
	së bëtin bëma, si do ti, mbëdhā.	425
<i>Roz</i>	Këtena mos u tund, o Milloshinë!	
<i>Em</i>	Popo si fjuturuonë! O herë e keqe!	
<i>Mon</i>	Si na rrëvove dreqe pjono dirë...	
<i>Pan</i>	...me helëmë e me ligrī tē na thartonje.	430
<i>Roz</i>	Çë bënëjëmi ani këtu, tē shkreta na, qëndruora po si vresht qëndronë pa hunjë, pa gardhe e pa tē ruome e je kanosurë derrashi, çë janë	
	tē dirëm' e dekur' uri? O qiellë, si vjove prë nē këtë s'hirī mos e penxuome, e një thërrimez mirë, çë bën' e pamë si rrëmb i llargh menaten tē ksaj dit,	435
	na vrëjte ndë një kred, e kush e dī çë vit' i rënd çë ka t' xarrisinjë prapa	
	e me sa timë e vapa i paguorë kē tē jëtë e me shërtimë e gjerë hjidh!	440
<i>Qir</i>	Via, mos helmohi keq e mos thërrini dëme mbi dëme trushi, e lodhën' ashtu shpirtin e fjandaksinë. Na jemi bil	445
	tē Perëndis e ajo së fjë mbi nē si varesurë njeri, çë nëng penxonë	
	më mikun o gjitonin o gjérinë, se pather dreqëtonë	
	ai tē bënët [t]ona, sa janë ndrishe,	450
	me urtëri tē madhe ndë një finë ku së rrëvonjëmi na, jo se me sī,	
	monu me fjandaksī.	453a
<i>Em</i>	O Qirjak,	453b

	ndë këtë njëmend u s' dī ç' ë gjella ime. Më dhifizën një keqe trëmbësime një shortje, sa ng' e gjegja më kurraj. Doj t' ikënja, doj të rrinja, doja të kishnja një fuqī të madhe të shumësonja stanë e qënën time	455
	ndë llaka e prë ndë brinja e kudo janë pjesa me timin gjak. Doja të bënja dju sa shërbise e monu një serposinjë. O mjera u, je llavure çë jamë! Si të serposinjë kamë sa mungu zura?	460
	Adunaremi allmonu mbë serpos se gjith harea, çë pata somenat, jo se m' u los si afërë zjarrit bora, moj nje m' u spav, si spaven ato rē çë shohmi cado herë ndë larta çuka	465
	të malevet ngalisura, ku bënjin me nina ndrishe hora e madhe turra e kastjèle me burra e cado tjera katunde shumë të gjera; moj rrëvonë dirëm e doquillore një vorë	470
	e, rature mbi ta, i shprishën, e lë kocorahjin e malit të xheshurë, pa fiteps e pjono gurë si një gramisurë murë i madh i madh.	475
Pan	O zonj, kë ligj, e, më se thua, vërteta jotja rëkime ësht, e u mbi tjera e njoh më thellë se kush së pati bil.	480
	Si nga pirikull çë mbëshonë mbi ta asaj i llaftarisën ndë krahnuar zëmëra ka trëmbësima je tramaksurë u dreq e njoh, se hera shum' e masa.	485
Qir	Mbero trëmbima kā vëlënixën edhe ndë ligj, e më tutje kush do t' e gjënë jep me topurë ndë rrënëjë të gjells' e tij. Nani nëng ësht i madh, sa e pindiksën dhezura fjandaksī, kī çë kanosën	490
	prikull i fōrt. Ata di trima janë të njohurë e sa panë me Turq ushtria vinxuanë e nëng u lanë t' ishin të mundurë. E ni kjo kauzjonë një fjet e rē	
	ndë kurorën lulzuome, ç' i nderonë ballin, i gadhënjenë e, të dokxorë kurë priren ndë katund, i kā më hjë.	495
Em	Qirjak, si fjet ashtu? Një rrotull vet mbëshuome mund e tundinjë te jetr' anë, i vénurë te staterja, një kandârë?	500
	Një krah, të jëtë i doq sa më ti do,	

	ngë lozën se një shpat o një mahjere. Tr̄i, katërë e pes e gjasht edhe i shtinë, moj një qind e një zet si mund i ruonjë? Monu me trū rrëvonë tē i penxonjë!	505
	O bil, si ju xarris i fogha e lig trimërishte ndë vā, ku mē pérpara vëdeqja s' bën' e shkonë ndonjë njeri.	
Mon	Popo, se një s'hirī mbi nj'etërë edhe ngalonet mē e rënde e dëmullore!	510
	Jemi tē zbjerra, o mëmë. Kjo dit prë nē qe prasëma çë na vjoi Zot' inë Theosi.	
Em	Monostane, çë ke?	513a
Roz	Çë pē tē riu mē lig se ai çë na kanosën i rënd?	513b
Mon	O jona shpī e gramisurë ndë një kred!	515
Qir	Çë kē prosteksurë ka dritsorja, o vash?	
Mon	Nje nisu, mëmë. Vemi këtena, vemi. Vinjin ka mali posht me vrapëtī, si gurë çë rrukullisen pa nëmrimë, Turq t' armatosurë ndrishe. Popo, popo!	520
	Çë fanë i lig me dorë tē hekurore na shtrëngonë e na shtridhën ndë ktë dit një herje gjith, pa fare lipisī.	
Em	Tē bëtin thomse sítë, o Monostane, tē dhezurë ka trëmbima çë tē mundi.	525
Qir	E vërteta tē tundi doqe ashtu tē bënë tē shihnde mizën prë një mal, se trëmbima, kurë çelën fjandaksinë, gjith shërbiset i madhën e i lartonë.	
Pan	O tē mos t' ish si është vërteta dreq! Rrangova u jasht e pē ka terimoni se janë e vinjin tuke ruorë këtena.	530
Em	O breshurë çë na sfjetën po si lule! Çë bënëmi, Qirjak? Cilin këshillë tē zgjedhëmi ndë ktë prikull i trimadh?	535
	U zbora trutë e dritën, e pa fuqī ndihemi gjith e je çotjasurë. Ku sallvohemi nani ka turqërishta egurore diriç çë na dhifizën?	
	O bila time fanizeza, fare një herë pandehja se një lumë si kī me qinë tē madhe kesh t' ju tillqij posht pérpara sivet [t]ime! O keq i shtrëmburë dhistinë çë na gramisën! Ku mënnonë, ka ruonë e ku pushonë i shurdhullorë	540
	pa zëmërë e lipisī, e bjegħerë e thirmë së gjegjën e sheh e luse me hjidhī?	
	Një jëmë, një jëmë tē parkalesën, e shtridhurë	545

	ka një s'hirī trimadhe. Poka e bëre me zëmërën tē njomë e me namurë trīdoq e dheze prej tē bilëtë, e ani tē shkreturë e lëshonë ndë pisullore dhëmbime pa një ndihme, e si kurë merr, ndë thirmë e ndë shërttime çë dërgonë tue lusurë, më pëlqeme kurë ajo tëhelqën e lëngonë?	550
<i>Mon</i>	O mëma ime, ndo fani na dëmoi tē biemi sod ndër afsin e vëdeqes çë kurraj së ndëndet, mos mallko! Të bënë Theosi sa do mbi në, se pather bënë si jatë çë nëng na do tē grisurë, moj me zjarrin tē dhurimes na lanë e bënë tē mirë pré gjellën tē dulirë ndë stoneonë.	555
	tëhelqën e lëngonë? <i>Mon</i> O mëma ime, ndo fani na dëmoi tē biemi sod ndër afsin e vëdeqes çë kurraj së ndëndet, mos mallko! Të bënë Theosi sa do mbi në, se pather bënë si jatë çë nëng na do tē grisurë, moj me zjarrin tē dhurimes na lanë e bënë tē mirë pré gjellën tē dulirë ndë stoneonë.	556a
		556b
<i>Mon</i>	O mëma ime, ndo fani na dëmoi tē biemi sod ndër afsin e vëdeqes çë kurraj së ndëndet, mos mallko! Të bënë Theosi sa do mbi në, se pather bënë si jatë çë nëng na do tē grisurë, moj me zjarrin tē dhurimes na lanë e bënë tē mirë pré gjellën tē dulirë ndë stoneonë.	560
<i>Qir</i>	O zonjë, duliru e mos thërrit ashtu! Mos na shprish më fuqinë çë rrī e na vete proposh ndë këto krede sellpizore. U mora një këshillë: derën e mbllita aprapaz me ca gurë shumë tē mbëdhenjë. Ni vete ndë katoqe e bënë edhe si bëra sipurë, e pré di koha mot na japën, ndo se zjarrin nëng i vënë ndë tē parën tē hjodhurë, e një kred, një koh, një gjims koh'je neve sosën tē na sallvonjë. Bir' imë edhe shpëtoi i madhi e vate aposhtaz, rdo mund shoh tët bil e t' i thérres. Ardhurë ata, së jemi më tē zbjerrurë si ani pandehjmi na.	565
<i>Pan</i>	I mbllita diertë, o Qirjak, i mbllita e prapa i shtita sa më munda gurë, qeramidhe e matune e bashk me mua shërbienë këta ghanjunë pa u trëmburë fare.	570
<i>Roz</i>	Rrëvuonë, o mëmë, rrëvuonë, e ndonjë di zet i nëmërova e pra së pata më zëmërë tē vrenja ato tē zezullore faqe turqishte, se më vrëjtin sitë.	575
<i>Em</i>	O pisullore dit, o pisullore monostrof dejtrore, çë rrëmbeve pllasin timë si nj' anī e, qeverrisurë mbi suvala tē larta, ni zgjeronë gulacin t' e përlutçë, si përlutën një afs i thellë e i gjerë një vogël shkëmb!	580
<i>Mon</i>	O zjarmë, çë kopanë çë më shërdhoi.	585
<i>Qir</i>	Dhanë te dera me shpata. Prë nani nëng e hapnjin edhe mos i vënë zjarr.	590
		595

<i>Pan</i>	E ti pandehjén se mënonjin shumë?	
<i>Roz</i>	O mëmë, përgjunju allmonu edhe me nē e truhemi me zëmërë Shën Mëris e Shëjteve tē shpīs.	599a
<i>Em</i>	O bilat [t]ime, xëni se zëmra ime ndë ktë kred jo luse e jo mallkime dī tē bënje.	599b 600
	Shpirti i fëtohurë nëng më thot më gjë e gjaku i piksurë tas më la si gurë pa ligj e pa këshillë, e zez si shujturë illë, e kī rrëmurë më shërdhoi e më mblliti mbjatu sitë.	605
<i>Mon</i>	Panaidhe, çë ke?	607a
<i>Pan</i>	Derën e ndajtin çë ndë fund njera lart, moj se tē hinjin i lipset tē dërsinjin nj'etëre cop.	607b
<i>Roz</i>	O qiellë, çë bënë! O shëjte tënë ndihorë! O ajrë, e kuj ja vjonë një mot i keq? Si ruonë thjellmorë këto shtrëmbura bëme?	610
<i>Pan</i>	Këtu, se gjegja nj'etëre bumbullime. Lejëm, se vete shoh.	614a
<i>Roz</i>	O Milloshinë,	614b
<i>Mon</i>	o Pjetroshinë, ku gjëndi ndë ktë kred? Ju, thomse tē lakosurë e tē shqerrurë mahjereshi pa nëmërë, vatë përpara e ruoni alartaz fanin tënë tē zī pa tē na ndihëni, e pritëni dulirisht kurë tē rrëvonjëmi na...	615 620a
<i>Një vashëz</i>	Harepsi, zonja! Trëmbimën e tramaksinë vëni mbë nj' anë. Vinjin vëllezërit [t]ej si di lionë tē dirëm e tue thërritur ashtu doq, sa llakat, çë na rrinë neve prë nënë, bumblinjin, si ndë male kurë gjëmonë.	620b 625
	Turqit ka llarghu i panë: iktin dica, ca t' i përpinqin vanë.	
<i>Mon</i>	E thomse i rrethulluanë?	628a
<i>Roz</i>	I kanë lakosurë?	628b
<i>Em</i>	O bil, çë ju vëleu se bënë mbi juve doksore kënëka, çë rrëfiejin bukurë luftat çë bëtë e nderën çë gadhnjetë ndë bëma jushtërore, ndë sa herë krahun e gjakun prë katundet vutë mbë prikull e prë horat albëreshe?	630
	E ni prë hajdhinë tej më reksi zëmëra, e mbushurë një hareje çë m' zgjeroj lughadhin tē një moti çë mund vij	
		635

	prë jū e prë mua i lart e i dokSORË. O, një herje nani mos e pandehjurë një nonostrof e keqe ju rrëvoi e doqe shumë ju [u] hjodh e ju rrëmbeu me dorë të hekurore e ju lakosi; ju copjasë e ju shtroi ndë truollë i ngürtë, si mish çë vet vëlenë, ndo zogjvet i pëlqenë të jëtë i ngrënë.	640
	Emirë, jo më! E murge tas më nget të më thërresën sodeparë ndë rrole, ndo se kultonjin më një bjerrafate, cila mbi jetën shkoi si zjarmë, çë vete i dhezurë nd' ajërë prë një kred shkëlqemë e spavurë prana bie ndë të zeze shkreti, çë pather hā e pather mbrazte rrī.	645
<i>Mon</i>	O mëmë, si me kto thëna rëkimore zëen më shqierë e ndë tramaksī më e thelle më shfínë s' edhe s' kamë rārë!	650
<i>Pan</i>	O bëna theosore! O qellișhte mirakul lartullörë! Ndë gjellën time si kjo më nëng e pë një rëndullore e madhe kopanë.	655
	E gjegja vetëm kurë jesha kopile, ndë vallë tue kënduorë një kënëk' e vjetërë, se Pirri vetëm, ndo se qe vërteta, ndajti një burr ka kreu njera ndë fund një kopaneje dreqte e je mbëshuome.	660
	Moj nani pa cjudhī, më shpejt me trëmbime e t' madhe tramaksī, e vrejta me sīt' [t]ime.	665
<i>Mon</i>	Çë vrejte, Panaidhe? U nëng ndilgonjë të folëtë çë ti bënë. Ndë tjera liga, me k' qilli na frushërën ndë ktë dit, na jep edhe të mos ndilgonjëmi më ato çë na rrëfienjin miri gjë.	670
<i>Pan</i>	Vrejta me cjudhī e me tērrurë, o Monostane, Pjetroshinin tēnd, cili aposhtonej rahjit, tek ë lisi deggjerë e ndënë kā lëmin, me një rrëmurë, si ai çë bënë një derr i madh i madh, kur' ikën prë ndë ferra ndëndullore.	675
	Shpatën e sillë të shqiturë e kumbisurë ndë mushkun i të djathtë e rrishkëlqej si parat rrëmb të diellit, kurë çë shkeptën ka çuka e malit ndë një llakat mbë sī t' atij ç' e ruonë kundrela. U përpinq	680
		685

	ndë katër Turq. Shpatën dhjasë posht: shkepti si drit pasqirje e rëndullore rā mbi tē parin e di pjesa e bëri. Të jetrit ngrah ju hjodhtin nd' at njëmend e u munxilastin bashk; moj pas një kred, si deg fitepsi, cila prë një rënde mbëshuome u kumbis, shkundet e zgjidhet asaj e ngrëhet lart më se përpara, ashtu trimi ji ngrëjturë mbal atire mbeti tē vrej, çë nëng u ngrëjtin më.	690
	Ahiena Milloshini dha ndë nj'etëre llojë çë ju përpoq e nj'etëre trī lakosi e vrarë la di. Nd' atë s'hirī Turqit përrëmburë gjith u shprishtin mbjatu si rikazish një murr, kurë dosat shquortin di ulëq dekur' uri e keq tē fōrt.	695
<i>Mon</i>	Mbajëm, o Panaidhe, mbajëm shtuora. Harea më dëmëtoi më se trëmbima e tramaksia, çë njer' nani më drodhi.	
<i>Pan</i>	O zonjë, mos u villirë ndë kët njëmend hareje. Motra jote tē përpinqij tē vllezrit vate, e ti zaliturë bie? O popo, bardhen krie tē ërëtullore ashtu më prënë ndë gjī, e si je dekurë ndë prëhërë ni më bie. Ajlimonō! Çë bënë e vetëme ashtu pa ndihme ani këtu?	700
<i>Ghanjunëtë</i>	O, si janë më pëlqeme e duken trëshkëlqeme rrëmbat e diellit, ndo vidhjore rē e vrëjtin prë një cop o moti keq na varesi me mjegull e me shī; sa na japën hajdhī, kurë priren prana tē shkëlqenjin mbi nē!	710
	Ngjallet ahiena e rē buftonetjeta gjith e dheu dërgonë kado vende një ninë çë na gëzonë.	715
<i>Vashazit</i>	Këndonjëmi nj' odh hirije Perëndīs, cila me nj' urtëri tē stoneonë psuomet gjith dreqtonë, e mirë e lig përzierënë e ëmbël e thārt me armonī tē larte e sandilguome, çë përhapet e mbllihet si do moti, cili bënë e grisën çëdo gjënë; e kurë njeriu me sīnë tē luturë e kërkonë mbi rē, ajo pushonë ndë nē, e kurë kā bes se prë mesin e mbanë e je shtrëngonë, ahiena nëng e çonë ndë duorë i ziu.	720
		725
		730

	Ashtu Theosi, tuke bënurë pjes të tharta e t' émbla po si rënda e leza, e t' ulëta e lartullore, e t' errëta e të shkëlqeme, me vërtet, jo me rreme, një masore ndë gjith bëna të dreqte na buftonë, cila me thavmasia,	735
	me spérënxa e hajdhia tuke bredhurë na mbjonë.	740
	Këtu qeshën një lule, atje një barë bihet e ngrëhet tuke kalthëruorë.	
	Mali merr drit e duket një xhaghënd me pine e faje i rënd më se Titanë, si kënkat neve thanë të motëme shumë.	745
	I thturbull ai lumë ujet ngjaronë e neve para shkonë tue vaturë posht, ku jati dejt e thirrën. Shtronë një faqe	
	me ohjistra monosaqe brinja je bukurushe.	750
	Një flludh e një lëpushe thot edhe me gjalprin çë fishkllenë, e zogun çë këndonë,	
	se gjith sa bëre qe, o trilarte Perndi, me t' urte urtëri.	755
Roz	Vinjin, vinjin, o mëmë, o Monostane, vinjin vëllezërit [t]ënë të kuroruorë me një kurorë doksore e bukurë, cila	
	së veshket më kurraj, e sodeparë ndë kënëka katundare e ndë kangjele, çë të këndonjin trima me kopile	
	prë ndë sheshe e ndë zale,	760
	ndër llaka e ndë gjith male, ëmër' i tire kā t' ekinjë e bumbllinjë, e Pjetroshini	
	e Milloshini mbaru prë ndë rrole, ndë lodra e ndë valle,	
	me mend cjudhiturë e me t' émbël gole,	765
	me shumë të thella malle, janë të kultuorë prë dreq	
	ka gjindja gjith, ghanjunë e trima e pjeq.	
Mon	Motëri, vërteta poka të lefterë, të shëndoshëm e të tërë	
	priren ndë në vëllezërit [t]ënë nani?	775
Roz	Mos mua ngë besën ti e Panaidhen monu,	
	ni njota se këtu vinjin tuke kënduorë	
	ghanjünë të kuroruorë me lule bardha	780

Mon
Em

e kufirmonjin sa tē tha Rozbardha.
Shihni, popo!, mbi shtrat mēmēn çē bēnē!
Bila, gjegja sa thoni e llaftaria
tē gjiut mē mēnonë tē mund ju fjas. 785
U nēnjen mbjatu ngas, çē shpirtin lidhën
me gjellë dhērishte, si kurë doj t' e çanja,
se trēmbima çē mē mundi
e doqe keq mē shkundi, gjith mē nxuori
fuqinë çē kishnja e, ndo qēndroj ndopak, 790
psuomet çē rrēfiejtit ju nani
m' e shprishtin dreq si nd' ajrin shprishet hiu.
Moj ni ndē zēe mē biu njē ēhojo,
nj' ellpize e njē trēmbime,
çē s' mun tē thomë çē bēnjin gjelljes time. 795

Ghanjunte

Njota, hinjëmi na pērpara
tē lezonjëmi kopanenë,
se harea çē madhe vjenë
bēnē mē dēm se njē trēmbim.

Ruoni ju, çē kini lara 800
lotshi sītē, e vrejni mirë
mos ngē vinjin me mē hīrë
hajdhet lagura dhēmbim.

Vashazit

Somenat, kurë pam i na
zotrat [t]ēnē ç' ertin kētu, 805
ndotin neve di shēndosh
deg tē gjerë e larta lis.

Ni na nditen di vashele
tē mbēdhenjē si di kastjèle,
çē janē stisura ndē male 810
kundërë cilvet ujtë u nis;

moj u gris tue ngarë njinje
e sē mundi t' i rrēvoj,
t' i rrēmbej e t' i shkallmoj.

Njota, mēmē, ndē prēhērē tēnd 815
lulet qajtura prē zbjerra,
tē sfjetisura e tē shqerra
ka njē doqe monostrof.

	Më tē gjalla e mirudhira, më tē bukura e dulira, mund i ngāç e hundësoç.	820
<i>Em</i>	O bil, ju shoh vërteta nj'etërë herë? Ju puthinjë e lloronjë? O, thtohure qëndronjë e' mund buftonjë pëlqeme më tē gjerë! Allmonu qiellin lusinjë, sa mundinjë vet me trū, po tē dërgonjë mbi jū theosore një bekuome e shumë dulī prë njera çë mbullihen këto sī, e prana më tutje njera ç' arvonë hera tē vini ju ndë stoneonë.	825
<i>Pjetr e Mill</i>	Anamesa nd' uj e zjarr shkuomë vërteta, o jona mëmë; qenë mbi nē me shkepte gjëmë, po së bëtin neve keq. Moj si griheza shkëlqenë hekurin e je hollonë, kjo bëne na lartōnë prë ndë trima e prë ndë pjeq.	830
<i>Mon</i>	Pjetroshinë, Milloshinë, vëllezërë tē përdashurë, eni sa ju llorohemi ndë xerk e ju puthinjë me mall tē dheztë e thellë, si një jëmë, çë ndë gjellë pa t' e pandehjjij sheh vëdektin birë. Vëllezërë tē fammirë, kuj ni, më se prë monë çë shkoi, namurë ju nget, e madhe kurë po lipset neve tē kemi sodeparë,	835
	tas çë nani, tē bërë më tē mbëdhenjë, ballin zbuloni dhafn'je i nderuorë, e lisi e luleshi tē bukuruorë, cilat së mund i thanjë zjarri i zilīs o se t' i sfjetinjë brima e tē nodhīs.	840
<i>Roz</i>	O vëllezërë, ndërroni, ndërroni këta veshura çë kini tē shqerrëta e tē kondrepsura me gjak turqisht e i mallkuorë. Shihni, ju qoshim truorë, ndo kini ndonjë lakos,	845
	t' e ngjeshëmi e t' i vëmi ato jatrī çë lipsen, më njinje tē tharten e tē bënjin ndonjë thimos, cila pra më tutje	850
		855
		860
		865

	mund na ndërronjë mbë lip të pasuren hajdhī.	
<i>Qir</i>	Rozbardhe, u nevojën e penxova më parë e tas dërgova	
	Panaidhen të mbjedh ca jatrīsore bare të fuqīsore, çë shëronjin lakosat më njëhere se njerī nëng e besonë kurraj.	870
	Ni vjenë ajo, e andaj solla këto di ngjeshëme, çë të rea qëndruonë së shoqes time, pas çë s' bëri më bil e prë kultuome të trimërīs i vjoi e ni ndë lipse i çoi.	875
<i>Mill</i>	Qirjak, sa ti vëlenë, së kamë u fjal t' e thomë, e pa përbleme ë jotja Panaidhe.	880
	Mua shpirtin një shpëlqeme më rëndën si një mal, pse ngë kamë si Lisëndri fanmirë ca rregjëria, o shumë turres o dhera, po të bëgatnja tëjën vobkëtī.	885
	Moj mirë e njoh mbero se prë jū ësht kjo bëgatëria e qofçë çë ju lartën e nderonë.	890
	E u sa i gjallë të rrī e kultonjë ndë gjith hera. Vërteta lipse kamë të madhe keq të jemë i jatrīsuorë, se ndë më vende [u] ndihemi lakosurë e prëthellë.	895
<i>Pjetr</i>	Penxove mirë, Qirjak, e urtërisht. Pes lakosa më bëtin mua ndë llörë, moj gjith të lea, çë deqje s' kanë trëmbime. Mbero t' i lë së dua	
	të hapta, të mos tharten e të bënjin me monë e pa jatrī dëmin çë s' bëtinë të ngrohta njer' nani. Andaj me mua e me timin vëllā ea vetëm ti te jetra kamarë me kto ngjeshëm' e bare,	900
	t' i vëmi mbi lakosa. E ju këndoni! O mëmë, o motëra, vashaz e ghanjunë, ndo mirë na doni, me sa mundni më oreks e armoni,	905
	e ënda e hajdhī, këndoni ju vitorjen, çë Perndia na dha mbi Turq të madhe e lartullore,	910
	sa ndë kto vende tonë nuk u ndia ndonj' etërë më e gjer' e bumbllisore.	

Kōrē

Kënduanë tē moçemit [t]jenë
Erkullin, Atllandin, Prometenë, 915
e aq sherbise thanë
mbi ta tē madhe, sa ato çë qenë
tē vërteta së janë
tē pasura mē bes, e si përralle
këndohen ndë kangjele prë ndë valle. 920
Çë sodeparë mbero ndë hora[t] tona
ditën e natën djelma, vasha e trima,
ndo se mirakul venë tuke kënduorë,
ngë thonë tē rreme si një herë i thanë,
kurë Atllandit ndë krah një mal i vunë, 925
e Prometheut i dhanë diellin mbi dorë,
e jashtë ka Pisa Erkullin tē gjallë
e suolltin si një peshk, marrurë ndë rrjet,
çë vjenë ka dejti i thellë tē des ndë zallë.
Nëng ésht ni parambote, 930
nëng ésht paravolirë, moj ésht vërtet
se vetëm ndë një dit,
mëngu ndë muoj o vit,
Turkish di qind i lufëtuonë di vet,
di zëmëra t' albëresha, çë së dinë 935
tē njohën ndë pirikul trëmbësinë.

FRANCESCO ANTONIO SANTORI

OTTAVO MELODRAMMA
MILOSCINO E PIETROSCINO

Personaggi

Miloscino e Pietroscino	<i>fratelli</i>
Emira	<i>madre</i>
Rosbarda e Monostània	<i>sorelle</i>
Ciriaco e Panaìdia	<i>servitori vaccari</i>
Coro di ragazzi e fanciulle	

La scena

è in una casa di campagna nei monti della Dibra superiore.

Si apre la scena in una sala, dove si vedono fanciulle e ragazzi apparecchiare la tavola con i loro genitori Panaidia e Ciriaco.

Pan Stendi bene la tovaglia,
ragazza mia, e presta più attenzione
alle cose che fai.
Noi oggi un grande onore,
quale non avemmo altra volta, 5
riceviamo a casa nostra.
La signora Emira e Monostania,
Pietroscino e Miloscino
con la fortunata Rosbarda,
bella ragazza, oggi con noi 10
abbiamo, oh che gioia!
Cir Hai colto i fiori che t'ho detto, figlio?
E tu altro quanti mazzetti di rose
hai intessuto insieme con gigli e giacinti?
Hai forse dimenticato il gelsomino ch'è nella valle 15
e l'amaranto che è alla fonte di sotto.
L'origanello l'hai unito con l'origano
e l'ampio tulipano? La melissa
profumata l'hai colta insieme coi garofani
variopinti attorno al fontanile? 20
Questo è il vostro giorno e come questo un altro
chi può dirlo se più vi capiterà?
Oggi a noi concedono un onore
da tutti invidiato
i nostri padroni e oggi ci tocca 25
rivelargli amore e grande affetto
in questa campagna e in questa casa
che, per quanto io misero ricordi, e ne ho di anni,
mai ebbe l'altissimo privilegio che qui venisse
a soggiornare la famiglia dei nostri signori 30
non dico per una settimana, ma nemmeno per qualche giorno.
Pertanto, ora che ci capita questo piacere,
passiamo lietamente le ore.
Ornate meglio che potete il corpo 35
e coprite la testa con varie corone,
indossate bracciali e belle collane
e gli orecchini fate
che siano pure di fiori
e, quando essi desineranno,
voi attorno danzate 40
la ridda e intonate una canzone.
Pan Ciriaco, Ciriaco, fa presto! Si sono radunati,
già sono entrati in casa.
Hai apparecchiato e provvisto la tavola
di pane e vino, piatti e bicchieri, 45
forchette e salviette e altri arredi eleganti?
Em e detti Ciriaco e Panaidia, tanta fretta
non abbiate per noi. Oggi vogliamo

stare in campagna non come nei palazzi,
tra oggetti e ricchezze
nobiliari; gradiamo qui
goderci l'aria più libera,
più tersa e più serena; e una burrata
posta sugli asfodeli
e senza piatto sotto; una candida 50
tenera ricotta servita sulla felce;
nella tazza il latte dolce e il pane morbido,
caldo come appena sfornato,
ci danno un piacere mai provato
al mondo. Se ora acconsentite
a farci un favore a cui teniamo,
che sia gradito a noi ed a voi non pesante,
fate come vi abbiamo detto
e sempre in cuore io più vi terrò.
Cir Nobile Pietroscino, guerriero fortunato, 65
e tu, valente e forte Miloscino,
che oggi mi confondete con uno splendido onore
quale mai ho pensato oppure sognato,
sedetevi come meglio potete alla mia mensa
apparecchiata con povertà, ma arricchita 70
della vostra alta presenza e del grande decoro
che diffondono queste dame illustrissime,
fortunate e serene,
belle e buone, ben note
in ogni luogo, 75
che vedono da noi
un cuore che vi ama e vola attorno
come farfalla, per fare ciò che vi spetta.
Mil L'accoglienza cordiale che ci hai fatto
vale più di una mensa che potrebbe apparecchiarsi 80
Alessandro o Pirro o il re di Napoli
o il Gran Signore dei Turchi.
Con quanta gioia desiniamo in questa zona
mai ci è capitato di farlo in qualche parte
come con questi giovani. 85
